

LIGJ
Nr.8332, datë 23.4.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7800, DATË 2.3.1994 "PËR PAGAT E GJYQTARËVE,
NDIHMËSGJYQTARËVE EFEKTIVË DHE PROKURORËVE", NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8082, DATË 7.3.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7800, datë 2.3.1994, ndryshuar me ligjin nr.8082, datë 7.3.1996 neni 1 ndryshohet si vijon:

"Pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të jenë sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij ligji".

Neni 2

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, përballohen brenda fondeve të Buxhetit të Shtetit për vitin 1998.

Ministria e Financave të bëjë detajimin e fondeve për çdo institucion.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 1998.

Pasqyra nr. 1

1. PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Kryetar	80000 lekë
2. Anëtar	68000 lekë

Pasqyra nr.2

2. PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS SË KASACIONIT

1. Kryetar	76000 lekë
2. Zëvendëskryetar	70000 lekë
3. Anëtar	64000 lekë

Pasqyra nr.3

3. PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

3.1. Në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Prokuror i Përgjithshëm	76000 lekë
2. Zëvendësprokuror i Përgjithshëm	64000 lekë
3. Prokuror i Gjykatës së Kasacionit	56400 lekë
4. Prokuror (drejtor drejtorie)	45750 lekë
5. Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme	43500 lekë

3.2. Në prokuroritë e apelit

1 . Prokuror rrethi	45750 lekë
2. Zëvendësprokuror rrethi	43500 lekë

3. Prokuror 39000 lekë

3.3. Në Prokurorinë e Rrethit Tiranë

1. Prokuror rrethi 43500 lekë
2. Zëvendësprokuror rrethi 39000 lekë
3. Prokuror 36000 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore 31200 lekë

3.4. Në Prokuroritë e rretheve

1. Prokuror rrethi 39000 lekë
2. Zëvendësprokuror rrethi 36000 lekë
3. Prokuror 33000 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore 31000 lekë

Pasqyra nr.4

4. PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

4.1. Në gjykatën e apelit civil dhe gjykatën ushtarake të apelit

1. Kryetar 56400 lekë
2. Zëvendëskryetar 47800 lekë
3. Gjyqtar 45000 lekë

4.2. Në Gjykatën e Rrethit Tiranë

1. Kryetar 45000 lekë
2. Zëvendëskryetar 39750 lekë
3. Gjyqtar 36750 lekë

4.3. Në gjykatat e rretheve

1. Kryetar 39750 lekë
2. Zëvendëskryetar 36750 lekë
3. Gjyqtar 34500 lekë

4.4. Ndihmësgjyqtarë efektive pranë gjykatave të rretheve

1. Ndihmësgjyqtarë 24000 lekë

Pasqyra nr. 5

5. PAGAT E INSPEKTORATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

5.1. Kryeinspektor dhe inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor 56400 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor 47800 lekë
3. Inspektor 45000 lekë

Shpallur me dekretin nr.2083, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani